



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	06.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	5942/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.731/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti anëtarë, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.731/2022 të datës 23.08.2022 të parashtruar nga ankuesi nga fshati kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore-vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.731/2022 të datës 23.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi masa disiplinore „Vërejtje me shkrim“ e shqiptuar ndaj ankuesit përmes shkresës me numër protokollit 05-3773, të datës 03.08.2022 të Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, në pozitën "Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime të Veçanta të Shërbimeve Shëndetësore", me datë 23.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7921/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "vërejtje" me numër protokollit 05-3773 të datës 03.08.2022, të shqiptuar nga Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore, me pretendimet ankimore se vërejtja i është shqiptuar në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.





Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërsa Këshilli më datë 09.09.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës prej 1/42 faqe .

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 4921/2022 të datës 23.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresa zyrtare- masa disiplinore "Vërejtje" e datës 03.08.2022 e shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ndaj ankuesit; E-mal i datës 23.09.2021 programi i TB; E-mal i datës 22.09.2022 programi i TB; E-maili datës 20.01.2022, planifikimi i barnave ATB, të linjës së parë dhe të dytë, final në formë tabela-rekomandimeve; E-mal i datës 03.08.2022 barnat antituberkulare; E-mal i datës 21.10.2021 barnat antituberkulare; E-mal i datës 20.10.2021 barnat antituberkulare prej ½ faqe; E-mail i datës 03.08.2022 Njoftim; E-mal i datës 12.07.2022 njoftim dhe E-mal i datës 12.07.2022 njoftim; Raporti i datës 11.08.2022 lidhur çështjet e ngritura për qëndrueshmërinë e furnizimit të terapisë Antituberkulare, prej 1/9 faqe; E-mal i datës 04.08.2022 për shqiptimin e vërejtjes njoftim; E-mal i datës 03.08.2022 për ankuesin për shqiptim i vërejtjes; Përgjigje ne ankese e datës 09.09.2022 me numër protokoli 5292/2022, Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i datës 08.05.2014; Akt emërimi i datës 10.03.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 05.02.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 11.02.2022; E-mail i datës 02.08.2022 Kërkesë; Raporti mujor i datës 01.04.2022; Raporti mujor i datës 02.08.2022; Raporti mujor i datës 02.02.2022; Raporti mujor i datës 03.03.2022; Raporti mujor i datës 04.04.2022; Raporti mujor i datës 04.05.2022; Raporti mujor i datës 06.06.2022; Raporti mujor i datës 01.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi në bazë të Ndryshim dhe plotësim të Akt Emërimit të datës 08.05.2014, është i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Veçanta Shëndetësore". Po ashtu sipas shkresave të lëndës Kolegji gjen se Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore përmes e-mailit te datës 22.09.2021 kërkon nga Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Veçanta Shëndetësore dhe Zyrtarja M.GJ që të dhënat e kërkuara nga Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë të dërgohen me prioritet lidhur me përdorimin dhe shpenzimin e barnave antituberkular, respektivisht të njoftoj Divizionin e Farmacisë në lidhje me stokun momental neper qendra dhe planifikimin për furnizim. Zyrtarja M.GJ me datë 23.09.2021 përmes e-malit zyrtar e njofton Udhëheqësin e Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore dhe Udhëheqësin e Divizionit për Shërbime të Veçanta Shëndetësore lidhur me përdorimin dhe shpenzimin e barnave antituberkular, ku thekson „se barna ka mjaftueshëm dhe me datë të skadimit deri në vitin 2023”. Ndërsa



menjëherë pas një muaji me datë 20.10.2021 Udhëheqësja e Barnatores Qendrore në SHSKUK njofton Ministrinë e Shëndetësisë gjegjësisht Divizionin e Farmacisë lidhur me skadimin e barnave antituberkulare dhe kërkon te rishqyrtohet planifikimi për furnizim. Me tutje Kolegji ne baze të shkresave të lëndes ka gjetur se në janar të vitit 2022 Zyrtarja M.GJ ka bërë kërkesë në Divizionin e Farmacisë për blerje të barnave antituberkular, ndërsa me datë 12.07.2022 Drejtorja e SHSKUS-së përmes emalit zyrtar njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë së prej një jave mungon terapia antituberkulare në Klinikën e Pomologjisë. Pas këtij njoftimi për mungese të barnave antituberkulare Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë kërkon nga Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore të ndërmarrë veprime lidhur me adresimin e çështjes si dhe të njoftohet se kur stabilizohet furnizimi me barnat e cekura .

Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, më datë 03.08.2022 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore „Vërejtje“, me arsyetimin se ankuesi si menaxher i drejtpërdrejtë ka dështuar të menaxhoj me zyrtarët e divizionit të tij, të cilët kanë dhënë informacione në e-mailin e datës 23 shtator 2021 se ka barna mjaftueshëm deri me 2023, ndërsa në janar 2022 është bërë kërkesë në Divizionin e Farmacisë për blerje të barnave të cilat mungojnë (të cilat janë në mospërputhje), gjë që ka çrregulluar furnizimin e rregullt, me kohë dhe të pandërprerë me barna kundër tuberkulozit duke shkaktuar mungesën e barnave adekuate për pacientët me TB, gjatë këtij vitit, si dhe duke përfshirë mos adresimin e skadimit të barnave tuberkulostatikë..duke konstatuar së ankuesi ka bërë shkelje të obligimeve të punës duke ju referuar nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore të datës 23.08.2022, pretendon që vërejtja e kontestuar përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo i plote i gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit material, respektivisht aplikim i gabuar i të drejtës materiale.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"* dhe nenit 46 po të të njëjtit ligj më të cilin përcaktohet se: *1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta.... 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. Kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazën e vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës rrjedh se Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit përmes emalit të datës 22.09.2021 kërkon nga Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime të Veçanta Shëndetësore dhe Zyrtarja M.GJ që të*



raportojnë lidhur me përdorimin dhe shpenzimin e barnave antituberkulare, respektivisht të raportojnë sipas kërkesës së Divizionit të Farmacisë në lidhje me stokun momental të barnave antituberkulare nëpër qendra dhe planifikimin për furnizim, ndërsa në bazë të provave të lëndës nuk është vërtetuar se ankuesi i cili mbanë pozitën *“Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Veçanta Shëndetësore”*, dhe zyrtarja e cila është në mbikëqyrjen e ankuesit kanë dhënë raport të detajuar lidhur me furnizimin e barnave të tuberkulozit (TB) të cilën e dëshmojnë provat dhe faktet e bashkangjitura nga të dy palët në procedurë administrative me rastin e shqiptimit të vërejtjes së datës 03.08.2022 për ankuesin si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i zyrtares e cila me datë 23.09.2021 ka deklaruar gjegjësisht kanë dhënë informata të pa sakta se ka barna për tuberkulozë (TB) mjaftueshëm dhe me datë të skadimit deri në vitin 2023, dhe po ashtu në email askund nuk ceket se bëhet fjalë vetëm për vitin 2021, ashtu siç pretendon zyrtarja në raportin e detajuar të datës 11.08.2022 lidhur me çështjet ngritura për qëndrueshmërinë e furnizimit të terapisë antituberkulare, kurse menjëherë pas një muaji pas njoftimit nga ana Udhëheqëses së Barnatores Qendrore të SHSKUK lidhur me skadimin e barnave antituberkulare e njëjta përmes e-mailit zyrtar të datës 21.10.2021 ka theksuar se, citoj: *“në lidhjen me skadimin e barnave antituberkulare (unë nuk kamë informacion nga me duhet të sqaroj se porosia e fundit e barnave antituberkular është bërë në korrik 2019..... Nga planifikimi për 750 pacient dhe buffer stocku 50 shtesë kemi ende barna në fund të vitit 2021 ...”*, e që në fakt zyrtarja në fjalë bie ndesh me deklarimin e saj përmes emailit të datës 23.09.2021 dhe për shkak neglizhencës së saj në punë respektivisht mos planifikimit me kohe për furnizim me barna të tuberkulozit (TB)ka pasur mungese të përkohshme të terapisë antituberkulare gjegjësisht pacientet me tuberkuloz nuk janë furnizuar me këtë terapi. Po ashtu në bazë të provave të lëndës Kolegji konstaton se ankuesi edhe pas njoftimit se në Klinikën e Pulmologjisë ka mungese të përkohshme të terapisë antituberkulare e kjo krejt për shkak të neglizhencës së zyrtareve të tij ai nuk ndërmerr asnjë veprim ndaj zyrtareve si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë.

Andaj mbi bazën e këtyre fakteve Këshilli vlerëson se Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore respektivisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „vërejtje“ të datës 03.08.2022 ndaj ankuesit, ka vepruar konform kompetencës së tij të përcaktuar në nenin 48 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“ 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”*, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, që lidhet me rastin konkret sepse ankuesi ka dështuar në menaxhimin e zyrtares së divizionit të tij respektivisht ankuesi nuk ka marrë veprimet e duhura ndaj zyrtares së divizionit e cila ka dhënë informata të pa sakta duke vënë në lajthitje divizionin e tij, me rastin e furnizimit dhe skadimit të barnave për tuberkuloz (TB), gjegjësisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se mos veprimi i ankuesi si mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ndaj zyrtares e cila ka neglizhuar punën bien ndesh me nenin 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *“Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.* Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore ka cilësuar drejt veprimet e ankuesit si shkelje e lehtë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që mbi këto arsye Kolegji vlerëson së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.



Andaj, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës respektivisht pas konstatimeve dhe të gjeturave si me larte si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.731/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.